

Jemi të Gjithë Fqinj

Fleta e Mësuesit

Vlerat

Respekt, Familiaritet, Diversitet, Tolerancë, Bashkëpunim, Mirëkuptim, Drejtësi, Barazi, Liri, Solidaritet

Qëllimet

Pedagogjike: Theksimi i rëndësisë së respektit dhe rregullave në marrëdhëniet fqinjësore dhe komunitare, ku mbizotëron ndryshimi. Stimulimi i tolerancës, përgjegjësisë dhe kontributit për mirëqenien e të tjerëve.

Praktike: Imagjinimi dhe zhvillimi e një komuniteti të mundshëm “ideal”, duke përcaktuar rregullat dhe parimet për zakonet e mira të bashkëekzistencës.

Pjesëmarrësit

Minimumi 3; Maksimumi 30

Kohëzgjatja

90 deri 120 minuta


Materialet

Fleta e aktivitetit, që i dorëzohet secilit nxënës;
Fragmente nga Traktati i Lisbonës dhe nga Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian;
Lapsa me ngjyre;
Tabak kartoni.

Përmbledhje

Mësuesi/ja duhet të sigurojë një shpjegim të shkurtër në lidhje me fragmentet nga Traktati i Lisbonës dhe nga Karta Themelore e të Drejtave të Bashkimit Europian përsa i përket qytetarisë Evropiane. Mësuesi/ja ndan klasën në grupe heterogjene me nga 4 deri 6 nxënës. Çdo grup duhet:

- Të krijojë një komunitet “ideal” (në një pallat, qytet, lagje, etj.) duke përfshirë etni të ndryshme, minoritete, kultura, besime fetare dhe klasa sociale;
- Të përgatisë një listë të rregullave dhe parimeve të sjelljes së mirë të bashkëekzistencës dhe bashkëjetesës midis fqinjëve, duke marrë në konsideratë analizimin e Traktatit të Lisbonës dhe Kartën Themelore, dhe të përdorin një tabak kartoni për të prezantuar komunitetin e tyre në fund të aktivitetit.



Jemi të Gjithë Fqinj

Fleta e Mësuesit (vazhdimi)

Shënime

Mësuesi/ja mund të krijojë një ambient konkurent pozitiv midis grupeve të punës. Tabakët e kartonëve të punuar nga grupet mund të ekspozohen në vendin e njoftimeve të shkollës që t'i vënë ato në dispozicion të komunitetit arsimor.

Për informacione të mëtejshme rreth Ditës së Fqinjësisë Europiane, ju lutem vizitoni faqen e internetit:

<https://country.european-neighbours-day.com/sq>.

Diskutimi

Pas prezantimit të të gjithë komuniteteve, duhet të realizohet një analizë globale e aktivitetit për të nxitur debatin midis nxënësve.

Cilat janë ngjajshmëritë dhe ndryshimet midis komuniteteve tuaja "ideale" dhe atyre ku jetoni aktualisht?

Çfarë do të donit të ndryshonit në lagjen tuaj? Çfarë mund të bëni ju për ta ndryshuar atë?


Në cilin nga komunitetet do të donit të jetonit? Pse?

Cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e të jetuarit në një komunitet të ndryshëm?

A mendoni se njerëzit në komunitetin tuaj që kanë etni, kultura dhe/ose besim fetar të ndryshëm, trajtohen në të njëjtën mënyrë si pjesa tjetër e komunitetit?

Si respektohen parimet e qytetarisë dhe barazisë në vendin tuaj? Cilët aspektesh mund të përmirësohen?

Cilat janë konkluzionet kryesore që nxjerrim nga ky aktivitet? Pati ndonjë ndryshim në këndvështrimin dhe sjelljen tuaj kundrejt njerëzve me etni, kulturë, besim fetar të ndryshëm pas këtij aktiviteti?



Jemi të Gjithë Fqinj

Fleta e Nxënësit

Analizoni Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit European, përshtatur në Traktatin European, në mënyrë që të identifikoni nenet që kanë lidhje me qytetarinë, përkatësisht me marrëdhëniet fqinjësore dhe komunitare.

Pas analizës, imagjinoni dhe krijoni një komunitet ideal në një qytet, lagje ose ndërtesë (pallat) që karakterizohet për sjellje të mira të bashkëekzistencës, bashkëjetesës dhe respektit midis fqinjëve dhe komunitetit.

Karakterizoni komunitetin – banorët, hapësirat, organizime, institucione. Përgatisni një listë rregullash të sjelljes së mirë të bashkëjetesës midis fqinjëve dhe paraqisni 5 situata të jetës së përditshme që ilustrjnë bashkëjetesën fqinjësore duke përdorur Kartën e të Drejtave Themelore si bazën kryesore. Organizoni informacionin në një tabak kartoni që të keni mundësi t'ia paraqesni klasës.

Dokumenta ndihmëse | Fragmente nga Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit European

DINJITETI

• **Neni 1 Dinjiteti njerëzor**

Dinjiteti njerëzor është i padhunueshëm. Ai duhet të respektohet dhe të mbrohet.

• **Neni 3 E drejta për integritet e personit**

Gjithkush ka të drejtën të respektojë integritetin e tij fizik dhe mendor.

• **Neni 4 Ndalimi i torturës dhe trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtërues**

Askush nuk duhet të jetë pre e torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtërues.

• **Neni 5 Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar**

Askush nuk mund të mbahet në skllavëri dhe robëri.

Askujt nuk duhet t'i kërkohet të kryejë punë me forcë ose të detyrueshme.

Trafikimi i qënieve njerëzore është i ndaluar.


LIRITË

• **Neni 6 E drejta për liri dhe siguri**

Gjithkush ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë së personit.

• **Neni 7 Respektimi i jetës private dhe familjare**

Gjithkush ka të drejtën që t'i respektohet jeta e tij private dhe familjare, shtëpiake dhe komunikimi.



Jemi të Gjithë Fqinj

Fleta e Nxënësit (vazhdimi)

- **Neni 8 Mbrojtja e të dhënave personale**

Gjithkush ka të drejtën që t'i mbrohen të dhënat personale që kanë lidhje me të. Të dhëna të tilla mund të përpunohen vetëm për qëllime të caktuara dhe vetëm me leje të personit në fjalë ose të bazuar në disa norma të tjera të përcaktuara në ligj. Gjithkush ka të drejtën që të zotërojë dhe përdorë të dhënat e grumbulluara në lidhje me të dhe për t'i konfirmuar ato.

Zbatimi i këtyre rregullave duhet të jetë subjekt i kontrollit nga një autoritet i pavarur.

- **Neni 9 E drejta për t'u martuar dhe e drejta për të formuar një familje**

E drejta për t'u martuar dhe e drejta për të krijuar familje duhet të garantohet në përputhje me ligjet kombëtare që drejtojnë ushtrimin e këtyre të drejtave.

- **Neni 10 Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar**

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë vetëm ose në bashkësi me të tjerët dhe në publik ose privat, për të manifestuar fenë ose besimin, në adhurim, mësimdhënie, praktikë dhe zbatim. (...)

- **Neni 11 Liria e të shprehurit dhe e informimit**

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë duhet të përfshijë lirinë për të pasur mendime dhe për të marrë dhe dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrje nga autoritetet publike dhe pa kufi. (...)

- **Neni 12 Liria e mbledhjes dhe asocimit**

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të lirisë së përfshirjes në të gjitha nivelet, veçanërisht në çështjet politike, sindikaliste dhe qytetare, që nënkupton të drejtën e secilit për të formuar dhe për t'u bashkuar me sindikatat për mbrojtjen e interesave të tij/saj. (...)

- **Neni 14 E drejta për arsimim**

Gjithkush ka të drejtën për arsimim dhe të marrë pjesë në trajnime profesionale dhe të vazhdueshme.

Kjo e drejtë përfshin mundësinë për të marrë arsim të detyrueshëm të lirë. (...)

- **Neni 15 Liria për të zgjedhur një profesion dhe e drejta për t'u angazhuar në punë**

Gjithkush ka të drejtë të angazhohet në punë dhe të ndjekë një profesion të zgjedhur ose të pranuar lirisht. (...)

- **Neni 17 E drejta e pronës**

Gjithkush ka të drejtën të zotërojë, shfrytëzojë, disponojë dhe trashëgojë pasuritë e tij të fituara sipas ligjit. Askush nuk mund të privohet nga pasuria e tij, përveç në rastin e interesit publik dhe nën kushtet e parashikuara me ligj, me kusht që kompensimi i drejtë të paguhet në kohën e duhur për humbjen e tyre. Përdorimi i pronës mund të rregullohet me ligj ashtu sikurse veprohet dhe është i nevojshëm për interesin e përgjithshëm. (...)



Jemi të Gjithë Fqinj

Fleta e Nxënësit (vazhdimi)

BARAZIA

- **Neni 20 Barazia përpara ligjit.**

Gjithkush është i barabartë përpara ligjit.

- **Neni 21 Jo-diskriminimi**

Çdo diskriminim i bazuar në çdo bazë, si gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, karakteristikat gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinioni politik ose ndonjë tjetër, anëtarësia në një pakicë kombëtare, pasuria, lindja, aftësia e kufizuar, moshë ose orientimi seksual duhet të ndalohej. (...)

- **Neni 22 Diversiteti kulturor, fetar dhe gjuhësor**

Unioni duhet të respektojë diversitetin kulturor, fetar dhe gjuhësor.

- **Neni 23 Barazia midis burrave dhe grave**

Barazia midis burrave dhe grave duhet të sigurohet në të gjitha fushat, duke përfshirë punësimin, punën dhe pagën.

Parimi i barazisë nuk duhet të pengojë miratimin dhe përshtatjen e masave që parashikojnë përparësi specifike në favor të seksit të nënpërfaqësuar.

- **Neni 24 Të drejtat e fëmijëve**

Fëmijët kanë të drejtë për një mbrojtje dhe kujdes të tillë pasi është e nevojshme për mirëqenien e tyre. Ata duhet të shprehin lirshëm pikëpamjet e tyre. Këto pikëpamje duhet të merren në konsideratë për çështjet që i prekasin atyre në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre. (...)

- **Neni 25 Të drejtat e të moshuarve**

Unioni njihet dhe respekton të drejtat e të moshuarve për të pasur një jetë me dinjitet dhe të pavarur si dhe për të marrë pjesë në jetën shoqërore dhe kulturore.

- **Neni 26 Integrimi i personave me aftësi të kufizuara**

Unioni njihet dhe respekton të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të përfituar nga masat e hartuara për të siguruar pavarësinë, integrimin social e profesional dhe pjesëmarrjen e tyre në jetën e komunitetit.

SOLIDARITETI

- **Neni 34 Siguria dhe ndihma sociale**

Unioni njihet dhe respekton të drejtën e perfitimit të sigurimeve shoqërore dhe shërbimet sociale që sigurojnë mbrojtje në rastet e lindjes, sëmundjeve, aksidenteve industriale, vartësisë ose pleqërisë dhe në rast të humbjes së punës, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ligji komunitar dhe ligjet e praktikave kombëtare. (...)

Për të luftuar përjashtimin social dhe varfërinë, Unioni njihet dhe respekton të drejtën për ndihmë sociale dhe strehim, në mënyrë që të sigurojë një ekzistencë të denjë për të gjithë ata që nuk kanë burime të mjaftueshme, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ligji komunitar dhe ligjet e praktikave kombëtare.



Jemi të Gjithë Fqinj

Fleta e Nxënësit (vazhdimi)

• Neni 35 Kujdesi shëndetësor

Gjithkush ka të drejtën t'i sigurohet kujdesi shëndetësor parandalues dhe për të përfituar nga trajtimi mjekësor nën kushtet e përcaktuara nga ligjet dhe praktikat kombëtare. Një mbrojtje e shëndetit të njeriut në nivel të lartë duhet të sigurohet në përcaktimin dhe zbatimin e të gjitha politikave dhe aktiviteteve të Unionit.

• Neni 37 Mbrojtja mjedisore

Një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit duhet të integrohet në politikat e Unionit dhe të sigurohet në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

TË DREJTAT E QYTETARËVE

• Neni 40 E drejta për të votuar dhe për t'u shpallur kandidat në zgjedhjet e përbashkëta

Çdo qytetar i Unionit ka të drejtë të votojë dhe të shpallet si kandidat në zgjedhjet bashkiake në Shtetin Anëtar në të cilin ai banon nën të njëjtat kushte si shtetasit e atij shteti.

• Neni 41 E drejta për administrim të mirë

Çdo person ka të drejtën që çështjet e tij të trajtohen në mënyrë të paanshme, me drejtësi dhe brenda një kohë të arsyeshme nga Institucionet dhe organet e Unionit.

Kjo e drejtë përfshin:

- të drejtën e çdo personi për t'u dëgjuar, para se të ndërmerret ndonjë masë individuale që mund të ndikojë negativisht tek ai ose ajo;
- të drejtën e çdo personi për të pasur në zotërim dosjen e tij/saj, duke respektuar interesat e ligjshme të konfidencialitetit dhe të sekretit profesional dhe të biznesit;
- detyrimin e administratës për të dhënë arsyet e vendimeve të tij.

DREJTËSIA

• Neni 47 E drejta për zgjidhje efektive dhe për gjykim të drejtë

Gjithkush, kur të drejtat dhe liritë të garantuara me ligjin e BE-së janë të dhunuara, ka të drejtën e një përfaqësimi efektiv para gjykatës në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Nen.

Çdokush ka të drejtë për një seancë të drejtë dhe publike brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj. Gjithkush duhet të ketë mundësinë të këshillohet, mbrohet dhe përfaqësohet.

Ndihma juridike duhet t'u vihet në dispozicion atyre që nuk kanë burime të mjaftueshme, pasi një ndihmë e tillë është e nevojshme për të siguruar akses efektiv në drejtësi.

• Neni 48 Supozimi i pafajësisë dhe e drejta për mbrojtje

Çdo person i akuzuar do të konsiderohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajtor sipas ligjit. Respekti për të drejtat e mbrojtjes të kujt do që është akuzuar duhet të garantohet.

